

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 07.07.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	10	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	5	
4. Problemi 4	5	
5. Problemi 5	5	
6. Problemi 6	10	
7. Problemi 7	10	
Total	100	

1. Kompania ABC, i cili është biznes tregtar dhe i regjistruar në TAK dhe TVSH deshiron të përfundoj veprimtarinë ekonomike. Si duhet të trajtohen stoqet të pashitura (për të cilat është zbritur TVSH) të cilat mbesin në fund, çregjistrimi i biznesit do të bëhet me datë 30 qershor 2017?
 - a) Stoqet do të fshihen nga librat;
 - b) Paraqiten si furnizime në periudhën e fundit ;
 - c) Pas mbylljes mund të shiten pa faturë;
 - d) Trajtohen si humbje për qëllime TAK.

2. Për qëllime tatimore për njohjen e KMSH në fund të vitit cila metodë lejohet për trajtimin e stoqeve?
 - a) Lejohet metoda LIFO;
 - b) Lejohet metoda FIFO;
 - c) Lejohet metoda NIFO;
 - d) Asnjëra më lartë.

3. Malsin Krasniqi në muajin Dhjetor 2017 ka pranuar pagën e 13-të në formë bonusi për shkak të performancës në shitje gjatë vitit. Si duhet të trajtohet kjo pagë për deklaram në muajin Dhjetor 2017?
 - a) Njëjtë sikurse paga e dhjetorit;
 - b) Si pagë sekondare;
 - c) Nuk tatimohet;
 - d) I bashkohet pagës bruto bazë të dhjetorit.

4. Biznesi CBA shpk veprimtaria afariste e të cilit është dhënia me qera e automjetëve, e cila për qëllime tatimore është biznes i regjistruar si Korporatë e Vogël me TVSH, si duhet të deklarohet tatimin e të hyrave nga qeraja në baza tremujore ky biznes?
 - a) Shërbyese me 9%;
 - b) Tregtare me 3%;
 - c) Shërbyese dhe tregtare me 10%;
 - d) Asnjëra më lartë.

5. Kompania "ART", në Tetor pranon një notë debitore nga kompania "TRA" për blerjet të cilat i ka bërë para dy muajve nga kjo e fundit. Nota debitore e pranuar nga "TRA" është në vlerë 1,900.40+Tvsh 18%. Për kompaninë "ART" kjo notë ka ndikim që:

- a) Rriten blerjet, rrit Tvsh e zbritshme;
- b) Rriten blerjet, rrit Tvsh e llogaritur;
- c) Rriten shitjet, rrit Tvsh e zbritshme;
- d) Rriten shitjet, rrit Tvsh e llogaritur.
6. Kompania BLU jep mallra për disa nga klientët e vet me marrëveshje me konsignacion. Si duhet të trajtohen mallrat e dhënë me konsignacion?
- a) Rregjistrohen si mallra në stoqe tek BLU;
- b) Rregjistrohen si mallra në stoqe tek klienti;
- c) Rregjistrohen si shitje nga ana e BLU;
- d) Rregjistrohen si blerje nga ana e klientit;
7. Kompania "GENCI" importon mall nga KINA. Vlera e faturuar nga kompania kineze është 9,000 Euro. Kosto e transportit nga Kina në Kosove është 1,000 Euro. Autoritet doganore kanë bërë rivlerësim të mallit për të cilën kanë vendosur bazën doganore në vlerë prej 14,000 Euro (pra malli është rivlerësuar me 5,000.00 euro). Poashtu sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) kjo bazë i nënshtrohet normës 10% taksë doganore dhe 18% Tvsh. Kompania "GENCI" e ka pranuar vendimin mbi bazën e paraqitur nga Dogana. Si duhet të trajtohet vlera e rivlerësuar për qëllime tatimore?
- a) Vlera e rivlerësuar trajtohet si shpenzim i pazbritshëm;
- b) Vlera e rivlerësuar i shtohet koston së mallit;
- c) Për vlerën e rivlerësuar nuk paguhet TVSH;
- d) Asnjëra më lartë.
8. Qiradhënësi ALFA, një biznes tregtar, lëshon faturën për një pasuri në baza mujore qiramarrësit "BETA" shpk. Vlera e faturës është 800.00. Sa duhet të **pagujë** qiramarrësi "BETA" shpk për këtë faturë Qiradhënësit ALFA. Fatura është subjekt i tatimit të qirasë sipas normës së aplikueshme të ligjit në Kosovë.
- a) 800.00 Euro;
- b) 728.00 Euro;
- c) 944.00 Euro;
- d) 872.00 Euro.
9. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme në mënyrë individuale të pronës së prekshme individuale sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore dhe atë sipas kategorisë si cilës i përket asetet përkatëse. Cila nga të mëposhtmet është e saktë?

- a) Kategoria 1: njëzet për qind (20%);
- b) Kategoria 2: pesëmbëdhjetë për qind (15%)
- c) Kategoria 3: dhjetë për qind (10%) dhe
- d) Kategoria 4: pesë për qind (5%);

10. Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto deri në pesëdhjetë mijë euro (50.000 euro), duhet të mbajë librat dhe regjistrimet në përputhje me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, janë me sa vijojnë:

- a) një libër të shitjes në të cilin të gjitha shitjet dhe kthimet duhet të regjistrohen;
- b) një libër të blerjes në të cilin të gjitha blerjet dhe kthimet duhet të regjistrohen;
- c) një ditar arke që regjistron të gjitha hyrjet dhe daljet në para të gatshme.
- d) të gjitha më sipër

1. Zyra e Regjistrimit duhet të ruajë përherë të gjitha shënimet dhe dokumentet, duke përfshirë dokumentet e pranuar ose të regjistruara.

E saktë

E pasaktë

2. Shoqëritë tregtare, subjekte të ligjit “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, duhet të verifikojnë të paktën një herë në gjashtë muaj, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim” dhe udhëzimit administrativ, shoqëritë tregtare të mëdha, të mesme dhe të vogla që kanë status juridik, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas standardeve ndërkombëtare për raportim financiar (IFRS) të plota.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në rastet kur tatimpaguesit paraqesin në ATK, kërkesë për pagesë të tatimit me marrëveshje me këste, interesi nuk do të rrjedh nga muaji që pason muajin në të cilin marrëveshja është vendosur deri sa është respektuar tërësisht.

E saktë

E pasaktë

5. Bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se gjashtë (6) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit vetëm për detyrimin tatimore të njëjtë.

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo transaksion mbi 1,000 euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitete ekonomike kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili person fizik afarist, ortakëri apo grupim i personave, që paguan qira, mban nëntë për qind (9%) të tatimit në të ardhurat bruto, në kohën e pagesës apo kreditimit.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale interesi në instrumentet financiare të cilat janë të lëshuara apo garantuara nga një Autoritet Publik i Kosovës i paguar tatimpaguesve rezident apo jo rezident është i përjashtuar nga të ardhurat e tatueshme.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, të ardhurat e përfituara nga grandet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit nuk janë të ardhura të tatueshme.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, një tatimpagues me të ardhura vjetore bruto prej 50.000 euro apo më pak për te zgjedhur që të përgatitin pasqyrat financiare dhe te paguaj tatim ne fitimin real duhet të dorëzojë një kërkesë për regjistrim në ATK, deri më 1 Prill të vitit aktual për të cilin tatimpaguesi kërkon të regjistrohet.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit “Për Shoqëri Tregtare”, shoqëria e regjistruar tregtare ose shoqëria e huaj tregtare, por jo ndërmarrja individuale mund të shfrytëzojnë një emër tjetër tregtar i cili është i ndryshëm nga emri i regjistruar zyrtar.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej nëntë përqind (9%) të bruto pagesës, në momentin e pagesës.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas Ligjit nr. 03/L-161 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, kur një metodë e regjistrimit të mallit të jetë zgjedhur nga tatimpaguesi, ajo metodë do të përdoret për vitin në të cilin është zgjedhur plus së paku për tri periudha tatimore shtesë.

E saktë

E pasaktë

15. Furnizim i barnave do të jetë i liruar nga ngarkesa me TVSH.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjit të TVSH-së, Notë krediti kuptojmë – dokument i lëshuar për qëllim të një rregullimi nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, pasi që të jetë lëshuar fatura tatimore ose një dokument që shërben si faturë, ku shuma e TVSH-së së ngarkuar në faturën tatimore ose në dokumentin që shërben si faturë, është me i vogël se obligimi real i TVSH-së për atë furnizim të tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit të TVSh-se, furnizimet me ujë, përveç ujit të ambalazhuar aplikohet norma e reduktuar (8%).

E saktë

E pasaktë

18. Puna provuese sipas Ligji të Punës mund të zgjatë më së shumti tre (3) muaj.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas Ligji të Punës, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, pagesa e kontributeve është e detyrueshme për të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe të punësuarit e huaj deri në moshën e pensionimit.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

Kompania FLATRA shpk me seli në Prishtinë, e regjistruar me TVSH ka prezentuar informatat në vijim sa i përket aktivitetit të saj afarist për 6 mujorin e parë të vitit:

Shitjet e tatueshme :	76,700.00 euro (përfshirë TVSH 18%)
Pagat :	4,800.00 euro (përfshirë KP të punëdhënësit)
Blerjet:	53,100.00 euro (përfshirë TVSH 18%)
Shp. e zhvleresimit :	1,800.00 euro
Stoqet në fillim të vitit :	17,100.00 euro (me kosto)
Stoqet në fund te vitit:	13,600.00 euro (me kosto)
Shpenzimet tjera me fature (përfshirë TVSH 18%):	3,776.00 euro
Shpenzimet tjera me fature (pa TVSH):	1,100.00 euro

Norma e tatimit në fitim është 10%.

Kërkesa:

Sa është marzha Bruto dhe Neto mbi shitjet për FLATRA shpk për periudhën 6 mujore të vitit ?

Zgjidhje:

Shitjet	65,000.00	<----- (76,700/1.18)
KMSH :		
Stoqet në fillim	17,100.00	
+Blerjet	45,000.00	<----- (53,100/1.18)
-Stoqet në fund	13,600.00	
	<u>48,500.00</u>	
Fitimi Bruto	16,500.00	
Shpenzimet e pagave	-4,800.00	
Shpenzimet e zhvleresimit	-1,800.00	
Shpenzimet tjera (me TVSH)	-3,200.00	<----- (3,776/1.18)
Shpenzimet tjera (pa TVSH):	<u>-1,100.00</u>	
Fitimi para tatimit	5,600.00	
Tatimi @10%	<u>-560.00</u>	
Fitimi Neto	5,040.00	

Marzha bruto mbi shitjet: $16,500/65,000 = 25.38\%$

Marzha neto mbi shitjet: $5,040/65,000 = 7.75\%$

Problemi 2**15 pikë**

Kompania OLA shpk për vitin që përfundon me 31.12.2017 kishte kishte paraqite këtë Balance të gjendjes dhe Pasqyrë të ardhurave:

Totali i Aktives	2,000,000
Totali i Pasives	1,000,000
Ekuitei Aksionar	1,000,000
Të ardhurat	2,000,000
Shpenzimet operative	(1,000,000)
Fitimi operativ	1,000,000
<hr/>	
Shpenzimet e interesit	(50,000)
Fitimi para tatimeve	950,000
<hr/>	
Tatimi në Fitim	(për tu kalkuluar)
Fitimi Neto	

Informacione shtese:

Të gjitha këto shpenzime të mëposhtme janë të përfshira tek shpenzimet operative;

1. Shpenzimet e zhvlerësimit sipas kontabiliteti janë më të larta për 2,800 euro se sa shpenzimet sipas ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave;
2. Shpenzimet e përfaqësimit dhe reklamës dhe promovionit së bashku janë 28,200 euro, 10% e vlerës janë shpenzime të reklamës dhe promovionit;
3. Provizioni e llogarive të arkëtushme prej 1,800 euro kanë të bëjnë me një klient të veçantë, kanë dështuar të gjitha hapat e mundshme të inkasimit;
4. Shpenzimet e edukativ-arsimor 9,000 euro kanë të bëjnë me dy punonjës të kompanisë nga të cilat për njërin 5,000 euro në një institucion sipas legjislacionit përkatës në Kosovë, edukim-arsimi i të cilit nuk lidhet me pozitën e këtij të punësuarit si dhe për shkollimin e një puntori tjetër prej 4,000 euro në një institucion që nuk është i akredituar sipas legjislacionit përkatës në Kosovë.
5. Qiraja për muajin Dhjetor 1,500 euro sipas marrëveshjes do të paguhet në shkurt 2018; në po në të njëjtin muaj do të ndalet tatimi në burim.
6. Shpenzimeve të donacionit janë të dokumentuara, vlera e tyre është 18,000 euro.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar ne Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë OLA shpk me 31.12.2017?

Zgjidhje

Të ardhurat	2,000,000
Shpenzimet operative	-1,000,000
Fitimi operativ	1,000,000
Shpenzimet e interesit	-50,000
Fitimi para rregullimeve	950,000
1 Zhvleresimi	2,800
2 Shpenzimet e përfaqësimit	5,200
4 Shpenzimet edukativ-arsimore	9,000
6 Donacioni	18,000
Fitimi para Donacionit	985,000
6 Shpenzimi i donacionit	(18,000)
Fitimi para tatimeve	967,000
Shpenzimi i tatimi @10%	(96,700)

2.->Shpenzimet e perfaqesimit dhe reklamës dhe promocionit total: 28,000

Shpenzimet e reklamës dhe promocionit: $10\% \times 28,200 = 2,800$

Shpenzimet e përfaqësimit: $28,000 - 2,800 = 25,200$

Shitjet $2,000,000 \times 1\% = 20,000$ euro => limit i lejuar i shpezimeve të përfaqësimit

$25,200 - 20,000 = 5,200$ => Shpenzime të papranuara

4.->Shpenzimet edukativ-arsimore prej 9,000 euro janë shpenzime të papranuara, meqenëse :

-për punonjësin e parë edhe pse edukimi i tij bëhet në një institucion që është i akredituar sipas legjislacionit përkatës në Kosovë, edukim-arsimi i tij **NUK** lidhet me pozitën e këtij të punësuar (pra duhet të plotësohen dy kriteret) si dhe -për punonjësin e dytë edukimi i tij bëhet në një institucion që **NUK** është i akredituar sipas legjislacionit përkatës në Kosovë(nuk plotësohet kriteri bazë).

6.->Fitimi para donacioni $985,000 \times 10\% = 98,500$ limiti i lejuar ; 18,000 euro vlerë e pranuar meqenëse është brenda limitit

Problemi 3

5 pikë

RIANI shpk ka pranuar akt vendimin e raportit final të kontrollës nga ATK me datë 23 Mars 2017 për periudhën tatimore 10/2015 të TVSH-së. Aktvendim e raportit final rezulton me tatim shtesë në shumë prej 12,300 euro.

Kompani RIANI shpk për këtë periudhe kishte deklaruar dhe paguar me datë 25.11.2015 obligimin tatimore prej 45,200 euro.

Kërkohet:

Sa janë gjordat dhe interesi për tatimin e nën deklaruar të dal nga kontrolli i ATK-së që kompania duhet paguar duke u bazuar në kalkulimet që parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore ?

Zgjidhje

1* Gjorda për nën deklarim tatimor	$12,300 \times 25\% = 3,075$
2* Gjorda për mos deklarim në kohe (1 muaj)	$12,300 \times 5\% = 615$
3* Gjorda për mos pagese në kohe (12 muaj)	$12,300 \times 12\% = 1,476$
4* Interesi (17 muaj \times 0.65%)	$12,000 \times 11.05\% = 1,359$
TOTALI	6,525

1* Neni 52 pika 1.2 i ligjit për procedurat ATK-së: nëse nëndeclarimi është më i lartë se 10 % ndëshkimi është 25% i shumës se nëndeclaruar.

2*Neni 51 pika 1 i ligjit për procedurat ATK-së: për mos deklarim të tatimit në kohë ndëshkim 5% për muaj max 5 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 1 muaj vonesë.

3*Neni 51 pika 2 i ligjit për procedurat ATK-së: për mos pagesë të tatimit në kohë ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj. Në rastin konkret kemi të bëjmë me 12 muaj.

4 * Neni 28 pika 1 i ligjit për procedurat ATK-së: deri në ditën e pagesës së tatimit llogaritet interes 0.65% në muaj. Në rastin konkret ne kemi të bëjmë me 17 muaj mos pagese të tatimit.

Problemi 4

5 pikë

Kompania BLENDI shpk për vitin që përfundon me 31.12.2017 kishte një fitim para donacionit prej 320,000 euro. Shpenzimet e donacionit për këtë viti ishin 45,500 euro.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë BLENDI shpk me 31.12.2017.

Zgjidhje

Fitimi para Donacionit	320,000
1*Shpenzimet e Donacionit	(32,000)
Fitimi para tatimit	288,000
Obligimi tatimit në fitim	(28.800)

$1 * 320,000 * 10\% = 32,000$ (limiti sipas ligjit)

$45,500 - 32,000 = 13,500$ (shpenzim i pa zbritshëm)

Problemi 5

5 pikë

Znj. Flandra në cilësinë e Inxhinieres kishte filluar punë në muajin maj 2017 tek Kompania "SMART Construction". Paga mujore ishte 1,200 euro dhe bonusi në fund të dhjetorit në vlerë prej 2,200 euro.

Kërkohe:

- Llogaritni detyrimin pensional dhe detyrimin e tatimit që janë ndalur në burim nga kompania SMART Construction për vitin 2017.
- Llogaritni deklaratën përfundimtare për Znj. Flandra dhe gjeni diferencën e tatimit në burim dhe detyrimin e tatimit për pagesë për vitin 2017.

Zgjidhje

a) Llogaritja e detyrimit pensional dhe detyrimit të tatimit në pagë:

Paga mujore: 1,200 euro

Pensioni $1,200 \times 5\% = 60 + 60 = 120 \times 8(\text{muaj}) = 960$

Tatimi $1,200 - 60 = 1,140$

$22,8 + (450 - 1140) \times 10\% = 22,8 + 69 = 91,80 \times 8 = 734,40$

Bonusi: 2,200 euro

Pensioni $2,200 \times 5\% = 110 + 110 = 220$

Tatimi $2,200 - 110 = 2,090 \times 10\% = 209$

Përmbledhje: KP = 960.00 + 220 = 1,180.00

TAP = 734.40 + 209 = 943.40

b) Llogaritja e deklaratës përfundimtare vjetore:

Te ardhurat $1200 \times 8 + 2,200 = 11,800$

KP = $11,800 \times 5\% = 590 + 590 = 1,180$

TAP = $11,800 - 590 = 11,210$ (baza për tatim)

$0 - 960 = 0$

$960 - 3000 = 4\% - 2040 \times 4\% = 81.60$

$3000 - 5400 = 8\% - 2400 \times 8\% = 192.00$

$5400 - 11,210 = 10\% - 5,810 \times 10\% = 581.00$

Obligimi per TAP 854.60

Diferenca: Tatimi në burim 943.40

Obligimi tatimorë 854.60

Rimbursim 88.80

Problemi 6

10 pikë

TREGTARI shpk regjistroi blerje gjatë Korrik/2017 në shumën 22,500 euro me normën standarde; blerje në shumën 7,400 euro me normën e reduktuar; shitjet vendore në këtë muaj ishin 35,000 euro me normën standarde dhe 12,000 euro me normën e reduktuar (Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë TVSH-në).

Në muajin Korrik 2017 TREGTARI shpk ka lëshuar një Note Debiti për një blerës për një shitje në muajin Shkurt 2017, vlera e TVSH-së në këtë Note Debiti është 770 euro (me normë standarde);

TREGTARI shpk po ashtu në këtë muaj kishte një kreditim të bartur nga muaji paraprak në vlerë prej 1,300 euro.

Kërkohet:

A ka detyrim të TVSH-së për të paguar në këtë muaj TREGTARI shpk, nëse po sa është obligimi? Plotëso deklaratën tatimore.

Zgjidhje

Libri i shitjeve

Shitjet me norme standarde	$35,000 \times 18\%$	=	6,300
Shitjet me norme të reduktuar	$12,000 \times 8\%$	=	960
Note Debiti e lëshuar	$4,277.77 \times 18\%$	=	770
TOTAL TVSH e llogaritur			8,030

Libri i blerjeve

Blerjet me normën standarde	$22,500 \times 18\%$	=	4,050
Blerjet me normën e reduktuar	$7,400 \times 8\%$	=	592
TOTAL TVSH e zbritshëm			4,642

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshëm - Kreditimi i bartur

TVSH e pagueshme = $8,030 - 4,642 - 1,300 = 2,088$ (obligim për pagesë)

Problemi 7

10 pikë

Kompania LURA më datë 31.12.2017 kishte këtë shpenzim të zhvlerësimit sipas kontabilitetit:

Grupi I - 12,500

Grupi II - 6,000

Grupi III - 25,000

Për grupin e parë kompania kishte një politike të zhvlerësimit 6% në vit, për grupin e dytë 15%, për grupin e tretë 12%. Kompania me 1 Nëntor të vitit 2017 kishte blerë një aset të grupit të tretë në vlerë prej 30,000 euro (zhvlerësuar sipas muajit për qëllime kontabël). Të gjitha asetet tjera janë blerë gjatë vitit 2016.

Kërkoet:

a) Llogaritni ndryshimin e zhvlerësimit në mes të kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të tatimeve sipas grupeve?

Zgjidhje

Grupi I

Kontabiliteti	$208,366 \times 6\% = 12,500$
Tatimet	$208,366 \times 5\% = 10,418$
Zvogëlim e zhvlerësimit	2,082

Sqarim: $12,500/6\% = 208,366$

Grupi II

Kontabiliteti	$40,000 \times 15\% = 6,000$
Tatimet	$40,000 \times 20\% = 8,000$
Rritje e zhvlerësimit	2,000

Sqarim: $6,000/15\% = 40,000$

Grupi III

Kontabiliteti aset i ri	$(30,000 \times 12\% = 3,600/12 \times 2) = 600$
Kontabiliteti	$203,334 \times 12\% = 24,400$
Total për Kontabiliteti	25,000
Tatimet aset i ri	$30,000 \times 10\%/2 = 1,500$
Tatimet	$203,334 \times 10\% = 20,334$
Totali për Tatime	21,833
Zvogëlim i zhvlerësimit	3,167

Sqarim: $25,000 - 600 = 24,400$

$24,400/12\% = 203,334$